



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 81

Tiranë – E martë, 17 maj 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 9567, datë 4.5.2016	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 4527
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 361, datë 13.5.2016	Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të Bashkisë Dibër, z. Shukri Xhelili..... 4527
Udhëzim i ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes nr. 3078, datë 18.4.2016	Për miratimin e tarifave tavan që do të përdorin personat juridikë dhe fizikë të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, si dhe laboratorët e etalonëve kombëtarë, jashtë Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë..... 4527
Udhëzim i ministrit të Zhvillimit Urban nr. 2, datë 15.4. 2016	Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 17, datë 17.10.2012, “Për procedurat e shitjes së banesave, pjesë përbërëse e objekteve në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, për Entin Kombëtar të Banesave, për qëllim privatizimi..... 4528
Udhëzim i ministrit të Zhvillimit Urban nr. 3, datë 25.4.2016	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 19, datë 13.9.2007, “Për përcaktimin e rregullave të përgjithshme të zbatimit të programit të banesave me kosto të ulët”..... 4529
Udhëzim i ministrit të Financave nr. 11, datë 6.5.2016	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”..... 4534
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 25, datë 10.5.2016	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr. 94, datë 2.2.2009 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2014-496(44), datë 23.1.2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë..... 4535
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 48, datë 29.4.2016	Mbi fillimin e procedurave për licencim e shoqërisë “Xhengo Energji” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kasollet e Selcës”..... 4539

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 49, datë 29.4.2016	Mbi fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Xhengo Energji” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike...	4540
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 50, datë 29.4.2016	Mbi fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Xhengo Energji” sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike...	4541
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 51, datë 29.4.2016	Mbi licencimin e shoqërisë “Liria Energji” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Shpella Poshtë 2”, me fuqi të instaluar 2300 kw.....	4541
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 52, datë 29.4.2016	Mbi licencimin e shoqërisë “Liria Energji” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	4542
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 53, datë 29.4.2016	Mbi licencimin e shoqërisë “Liria Energji” sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.....	4542
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 54, datë 29.4.2016	Mbi fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “AE Distribution” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike	4543
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 55, datë 29.4.2016	Mbi fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “AE Distribution” sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike	4543
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 56, datë 29.4.2016	Mbi fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike	4544
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 57, datë 29.4.2016	Mbi fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Daab Energy Group” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Dobrenjë–Tomorricë, me fuqi të instaluar 2400 kw.....	4545
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 58, datë 29.4.2016	Mbi fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Daab Energy Group” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	4545
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 59, datë 29.4.2016	Për fillimin e procedurave për miratimin e “Kushteve të përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”.....	4546
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 60, datë 29.4.2016	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e draftregullores për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes.....	4546
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Jovan Doce.....	4547
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Vezire Gishti.....	4547
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Imer Dema	4547
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Ahmet Dema.....	4547
	Tabelat e sakta me pasqyrimin e kolonës së çmimeve, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 14, datë 5.2.2016.....	4548

**DEKRET****Nr. 9567, datë 4.5.2016****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Mimoza Yzeir Allaraj
2. Aferdita Ujkë Ajković (Sterkoj)
3. Olsiana Muharrem Peshkepia (Stafuka)
4. Bogiq Savo Radusinović
5. Milorad (Gezim) Llabut Radusinović (Dritarja)
6. Fatmir Ibrahim Zeqiri
7. Andi Fatmir Zeqiri
8. Pranvera Hajri Begu
9. Lurid Lulzim Mavraj
10. Erjola Andon Klarhold (Papa)
11. Diana Fran Pjetërgjokaj (Mrishaj)
12. Dorjan Sami Shabani
13. Nikolla (Nikola) Janko Kontiq
14. Jordan (Adriatik) Gjorgje Krstović (Nikollaj)
15. Ajet Abedin Mailaj
16. Artan Myzafer Baho
17. Alma Hilmi Gashi (Kadija)
18. Mirvjen Remzi Gashi
19. Gert Viron Kristo
20. Rado Gjuro Vukçević (Malaj)
21. Vilma Danil Vukçević (Nikollaj)
22. Diter Frederik Konini
23. Mare Petro Šoć (Dimnaku)
24. Dragan Vido Šoć (Shoqja)
25. Zdenka Marko Šoć (Zlatičanin)
26. Mishko Janko Kontiq
27. Olti Niko Naska
28. Rovenja Savo Zlatičanin (Kontiq)
29. Srđan Jordan Krstović

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bujar Nishani**

VENDIM**Nr. 361, datë 13.5.2016****PËR SHKARKIMIN NGA DETYRA TË
KRYETARIT TË BASHKISË DIBËR,
Z. SHUKRI XHELILI**

Në mbështetje të neneve 100 e 115, pika 1, të Kushtetutës, dhe të shkronjës “a”, të nenit 62, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shkarkimin nga detyra, për shkak të shkeljeve të rënda, të kryetarit të Bashkisë Dibër, z. Shukri Xhelili.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

UDHËZIM**Nr. 3078, datë 18.4.2016****PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TAVAN
QË DO TË PËRDORIN PERSONAT
JURIDIKË DHE FIZIKË TË
AUTORIZUAR NGA DREJTORIA E
PËRGJITHSHME E METROLOGJISË,
SI DHE LABORATORËT E ETALONËVE
KOMBËTARË, JASHTË DREJTORISË SË
PËRGJITHSHME TË METROLOGJISË**

Në mbështetje të ligjit nr. 9875, datë 14.2.2008, “Për metrologjinë”, i ndryshuar, neni 63, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, ministri i Zhvillimit të Ekonomisë, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

UDHËZON:

1. Personat juridikë dhe fizikë të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, si dhe laboratorët e etalonëve kombëtarë, jashtë Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, përdorin tarifa jo më të larta se sa tavanet përkatëse për shërbimet metrologjike, të përcaktuara në tabelat nr. 1, tabela nr. 2 dhe tabela nr. 3, të cilat janë pjesë e këtij udhëzimi.

2. Personat juridikë dhe fizikë të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë për kryerjen e shërbimeve metrologjike, të përdorin si tarifa tavan gjatë kryerjes së shërbimeve



metrologjike të përcaktuara në autorizim, tarifa të njëjta si për subjektet vendase, ashtu dhe ato të huaja, që ushtrojnë veprimtari prodhimi ose shërbimi në Republikën e Shqipërisë.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi personat juridikë dhe fizikë të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, laboratorët e etalonëve kombëtarë jashtë Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, për monitorimin e tyre.

MINISTRI I ZHVILLIMIT EKONOMIK,
TURIZMIT, TREGTISË DHE
SIPËRMARRJES
Milva Ekonomi

Tabela 1

TARIFAT TAVAN PËR VERIFIKIMIN PERIODIK TË
MATËSVE TË UJIT NË PRURJEN NOMINALE Q_n

- Deri në 5 m ³ /h	650 lekë/copë;
- Mbi 5 m ³ /h deri në 50 m ³ /h	900 lekë/copë;
- Mbi 50 m ³ /h deri në 100 m ³ /h	1 050 lekë/copë;
- Mbi 100 m ³ /h deri në 200 m ³ /h	2 050 lekë/copë;
- Mbi 200 m ³ /h deri në 500 m ³ /h	5 150 lekë/copë;
- Mbi 500 m ³ /h	10 300 lekë/copë.

Tabela 2

TARIFAT TAVAN TË SHËRBIMIT PËR
VERIFIKIMIN E VËLLIMIT TË CISTERNAVE
RRUGORE (AUTOBOTEVE)

Nr.	Emërtesa	Tarifa (në lekë)
1	Deri në 5000 dm ³	7000
2	Mbi 5000 dm ³ deri 10000 dm ³	8000
3	Mbi 10000 dm ³ deri 15000 dm ³	9200
4	Mbi 15000 dm ³ deri 20000 dm ³	10000
5	Mbi 20000 dm ³ deri 25000 dm ³	11000
6	Mbi 25000 dm ³ deri 30000 dm ³	12000
7	Mbi 30000 dm ³	13000

Për verifikimin e autoboteve (cisterna rrugore) me shumë ndarje, të ndara nga njëra-tjetra, kur verifikimi i ndarjeve bëhet në të njëjtën kohë, pagesës së kapacitetit të autobotit, i shtohet pagesa prej 50% të verifikimit të vëllimit përkatës të çdo ndarje.

Tabela 3

TARIFAT TAVAN TË SHËRBIMIT PËR
VERIFIKIMIN E VËLLIMIT TË
VAGONCISTERNAVE

Nr.	Emërtesa	Tarifa (në lekë)
1	Vagoncisterna deri 25000 dm ³	16000
2	Vagoncisterna mbi 25000 dm ³	20000

Shënim. Tarifat tavan në tabelat e mësipërme janë në vlerë totale, përfshirë TVSH-në.

UDHËZIM

Nr. 2, datë 15.4.2016

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 17, DATË 17.10.2012, “PËR PROCEDURAT E SHITJES SË BANESAVE, PJESË PËRBËRËSE E OBJEKTEVE NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT, PËR ENTIN KOMBËTAR TË BANESAVE, PËR QËLLIM PRIVATIZIMI

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit”, të ndryshuar, të vendimeve të Këshillit të Ministrave për kalim objektësh në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit për Entin Kombëtar të Banesave, më qëllim privatizimi,

UDHËZON:

Në udhëzimin e MPPT-së nr. 17, datë 17.10.2012, “Për procedurat e shitjes së banesave, pjesë përbërëse e objekteve në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për Entin Kombëtar të Banesave, për qëllim privatizimi”, i ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 2, pika 2.1, rreshti i tretë pas fjalëve “akteve respektive”, bëhet ndryshimi me këtë përmbajtje: “dhe pasi të jetë lëshuar nga zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, certifikata e pronësisë në emër të EKB-së”.

2. Në pikën 2, pas pikës 2.2 shtohet pika 2.3 me këtë përmbajtje:

2.3 Brenda 15 ditësh nga data e lëshimit të certifikatës së pronësisë nga ana e ZVRPP-së, në emër të EKB-së, kjo e fundit të ketë kryer njoftimin e të gjithë qytetarëve përfitues, sipas listës bashkëngjitur VKM-së përkatëse, në lidhje me afatet në dispozicion, procedurat dhe dokumentacionin e nevojshëm, duke marrë kundërfirmën e qytetarëve për të faktuar njoftimin e kryer”.

3. Në pikën 4, “Vlera totale e privatizimit të banesës”, pika 4.1 në fund të paragrafit: “K-është kostoja lekë/m² për sipërfaqen e ndërtimit të objektit, referuar vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 310, datë 21.4.2011, “Për përcak-



timin e koston mesatare lekë/m², për projekte shtetërore të transformuara në fond banesash, kaluar në përgjegjësi administrimi të Entit Kombëtar të Banesave, me qëllim privatizimi për banorët posedues, sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave, të periudhës 2009–2011”, shtohet fjala “i ndryshuar”.

4. Në pikën 5, “Lidhja e kontratës, mënyra e likuidimit të banesës dhe përmbajtja e dosjes”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

- Pika 5.1, germa “a” dhe “b” shfuqizohen dhe riformulohen si më poshtë vijon:

a) Çdo qytetar, sipas pikës 2 të këtij udhëzimi, detyrohet të lidhë kontratën e privatizimit me Entin Kombëtar të Banesave brenda 2 (dy) vjetësh nga momenti i lëshimit të certifikatës së pronësisë nga ZVRPP-ja, në emër të Entit Kombëtar të Banesave.

Për objekte certifikata e pronësisë të cilëve ka dalë para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, si afat fillestar i numërimit të periudhës 2-vjeçare, të merret data e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi.

- Në pikën 5.1, germa “c” bëhet “germa “b”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ZHVILLIMIT URBAN
Eglantina Gjermeni

UDHËZIM
Nr. 3, datë 25.4.2016

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË UDHËZIMIN NR. 19, DATË 13.9.2007,
“PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE
TË PËRGJITHSHME TË ZBATIMIT TË
PROGRAMIT TË BANESAVE
ME KOSTO TË ULËT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 34/1, germa “c”, të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit”, i ndryshuar, ministri i Zhvillimit Urban,

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 19, datë 13.9.2007, “Për përcaktimin e rregullave të përgjithshme të zbatimit të programit të banesave me kosto të ulët”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 5 shtohen pikat 5/1 dhe 5/2, si më poshtë:

“5/1. Nëse qytetari (familja) i/e miratuar me vendim të këshillit bashkiak përkatës, nuk paraqitet për/ose nuk pranon lidhjen e kontratës brenda një periudhe kohore 1-mujore (një-mujore) nga njoftimi i kryer nga EKB-ja, ky i fundit i drejtohet për zëvendësimin e këtij qytetari Këshillit Bashkiak, i cili përcakton një qytetar tjetër për t’u trajtuar me strehim në këtë apartament.

5/2. Në rast se këshilli bashkiak përkatës, brenda një periudhe kohore 5-mujore (pesë-mujore), nuk bën zëvendësimin me një familje tjetër përfituese, EKB-ja me vendim të Këshillit Drejtues të institucionit, pas miratimit nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, shet apartamentin në tregun e lirë.”.

2. Pika 6 ndryshohet si vijon:

“6. Vlera e apartamentit të ndërtuar apo të blerë llogaritet sipas pasqyrave 1 e 2, bashkë-lidhur këtij udhëzimi nga Enti Kombëtar i Banesave dhe shlyhet nga familja me këste nga 25 deri në 35 vjet, me normë interesi prej 2.0% në vit, në bazë të nivelit të të ardhurave familjare, me kusht që kësti mujor të mos jetë më i madh se 35% e të ardhurave mujore. EKB-ja harton planin e amortizimit për çdo familje përfituese, i cili do të jetë pjesë përbërëse e kontratës.”.

3. Pas pikës 6, shtohen pikat 6/1 deri në 6/9, si më poshtë:

“6/1. Në rastet kur qytetari/familja kërkon të shlyejë në mënyrë të menjëhershme vlerën e mbetur të çmimit të apartamentit, detyrohet të paguajë shumën e kësteve të përcaktuara deri në momentin e likuidimit, kamatëvonesat (nëse ka), si dhe vlerën e detyrimit të mbetur deri në këtë moment, i llogaritur në formë principali.

Kur familja shlyen vlerën e banesës, duke u bërë pronare e saj, enti lidh kontratën përfundimtare me kushtet e përcaktuara në ligjin nr. 9232, datë 13.5.2004.

6/2. Në rastet kur familja përfituese ka lidhur kontratë me entin, para daljes së udhëzimit nr. 19, veprohet si më poshtë:

a) Në rastet e pamundësisë financiare për shlyerjen e kësteve, sipas kontratës, enti bazuar në dokumentacionin e nivelit të të ardhurave familjare të paraqitura nga kjo familje dhe verifikimin në vend, bën rillogaritjen e kështit që do të paguhet, sipas kushteve të përcaktuara në pikën 6 të këtij udhëzimi, duke zgatur afatin e



shlyerjes deri në 35 vjet, i cili fillon nga momenti i lidhjes së kontratës së mëparshme.

Në momentin e lidhjes së kontratës së re qytetari duhet të shlyejë kamatëvonesat e prapambetura, brenda 1 viti kalendarik.

Llogaritja e kështit mujor të bëhet mbi bazën e vlerës së mbetur të apartamentit, ku do të përfshihen edhe kështet e papaguara deri në momentin e rilidhjes së kontratës.

b) Kur vlera e apartamentit nuk është shlyer brenda afateve të përcaktuara në kontratë, lidhet një kontratë shtesë për shlyerjen e detyrimit të mbetur, me një afat kohor 5–10 vjet, në varësi të nivelit të të ardhurave familjare, me interes 2% në vit, me kësht mujor jo më të vogël se 2.500 lekë. Afati i shlyerjes fillon me nënshkrimin e kontratës shtesë.

6/3. Në të gjitha rastet, nëse pas rillogaritjes rezulton se kështi është më i lartë se 35% të të ardhurave mujore, familja kalon në kontratë qiraje sociale. Për vlerësimin e kështit të përbalueshëm përdoren kriteret e mëposhtme:

a) Shtyrjen e afatit deri në 35 vjet

b) Kështi mujor jo më i lartë se 35% e të ardhurave

c) Të ardhurat mujore familjare, pas pagimit të kështit të mos bien nën nivelin e ndihmës ekonomike.

6/4. Nëse qytetari/familja pranon të lidhë kontratën e qirasë, referuar pikës 6/3 të këtij udhëzimi, EKB-ja lidh kontratën e qirasë me kryefamiljarin. Llogaritja e qirasë i referohet nenit 11, pika 2, të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, i ndryshuar, sipas pasqyrës nr. 3, bashkëlidhur udhëzimit. Kostoja e ndërtimit t'i referohet pjesës së pashlyer të detyrimit.

6/5. Referuar nenit 24, të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, i ndryshuar, qiraja e përbalueshme të llogaritet jo më shumë se 25% e të ardhurave mujore familjare, të verifikuar në bazë të dokumentacionit përkatës që duhet të dorëzojë familja, por jo më pak se 2500 lekë në muaj.

Për familjet që nuk kanë mundësi financiare për të shlyer qiranë mujore, MZHU-ja planifikon

fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë sociale, në masën që përcaktohet nga enti për mbulimin e shpenzimeve për menaxhimin e mirëmbajtjes.

6/6. Kur familja nuk shlyen qiranë mujore për 3 muaj rresht për arsye të pajustificuara, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 12, të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, i ndryshuar, EKB-ja zgjidh kontratën e qirasë dhe ndjek procedurat ligjore për lirim të banesës.

6/7. Për banesën e liruuar, EKB-ja i kërkon këshillit bashkiak të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse referuar pikës 1 të këtij udhëzimi, që të zëvendësojë familjen me një familje tjetër të pastrehë, për t'u trajtuar me strehim në këtë apartament.

6/8. Për të siguruar që banesat e dhëna me qira të jenë në përputhje me standardet e ndërtimit, mbi bazën e të cilave ato janë ndërtuar, EKB-ja planifikon fonde për mirëmbajtjen e këtyre banesave, në bazë të preventivave përkatës. Fondet për mirëmbajtje duhet të mbulohen nga fondet e akumuluar nga qiraja sociale.

6/9 Fondet e planifikuara për mirëmbajtje dhe kriteret për administrimin e këtyre banesave të dhëna me qira, miratohen nga këshilli drejtues i institucionit.”.

4. Në pikën 7 hiqet shprehja “Për rastet që parashikohen në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, shpenzimet administrative përballohen nga Buxheti i Shtetit.”

5. Ngarkohet Enti Kombëtar i Banësive për zbatimin e këtij udhëzimi.

(Pjesë përbërëse të këtij udhëzimi janë bashkëlidhur formulari nr. 3 për llogaritje të kostos së ndërtimit dhe formulari nr. 4 për llogaritjen e vlerës së qirasë sociale.)

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ZHVILLIMIT URBAN
Eglantina Gjermeni



FORMULARI NR. 3

LLOGARITJA E KOSTOS SË NDËRTIMIT

1. VLERA E SHPENZIMEVE TË NDËRTESESË

a) Vlera e investimit për ndërtimin e ndërtesës	_____
b) Vlera e plote e projektit teknik	_____
c) Kostoja e blerjes së tokës, kur ajo nuk është pronë e bashkisë	_____
ç) Vlera e investimit për lirim të sheshit të ndërtimit	_____
d) Vlera e mbikëqyrjes së punimeve	_____
dh) Taksat, tatimet dhe tarifat e aplikueshme gjatë ndërtimit të objektit	_____
e) Kostot e menaxhimit të zbatimit të projektit	_____
ë) Kostot për kolaudimin dhe tarifat e regjistrimit të pronës në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme	_____

SHUMA I

LEKË

2. NË KOSTON E NDËRTIMIT NUK PËRFSHIHEN, ZBRITEN:

a) Vlera e truallit, kur investimi është bërë në truall, pronë e bashkisë	_____
b) Investimet për lidhjen me rrjetin kryesor të infrastrukturës, si: ujësjellës, kanalizime, telefoni, energji elektrike	_____
c) Vlera e investimit për katet e para, kur këto nuk janë të parashikuara për banesa sociale	_____
ç) Taksat, tatimet dhe tarifat vendore të cilat për projektin në fjalë, mund të jenë konsideruar, si kontribut i bashkisë	_____

SHUMA II

LEKË



3. KOSTOJA E PËRGJITHSHME E NDËRTIMIT (SHUMA I - SHUMA II)

LEKË

Shembull

1. VLERA E SHPENZIMEVE TË NDËRTESESË

a) Vlera e investimit për ndërtimin e ndërtesës	84630955	84630955
b) Vlera e plotë e projektit teknik	0	
c) Kostoja e blerjes së tokës, kur ajo nuk është pronë e bashkisë	0	
ç) Vlera e investimit për lirimimin e sheshit të ndërtimit	0	
d) Vlera e mbikëqyrjes së punimeve	70000	
dh) Taksat, tatimet dhe tarifat e aplikueshme gjatë ndërtimit të objektit	4499549	4499549
e) Kostot e menaxhimit të zbatimit të projektit	3881225	
ë) Kostot për kolaudimin dhe tarifën e regjistrimit të pronës në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme	400000	

SHUMA I

LEKË

93,481,729

2. NË KOSTON E NDËRTIMIT NUK PËRFSHIHEN, ZBRITEN:

a) Vlera e truallit, kur investimi është bërë në truall, pronë e bashkisë	0
b) Investimet për lidhjen me rrjetin kryesor të infrastrukturës, si: ujësjellës, kanalizime, telefoni, energji elektrike	2577136
c) Vlera e investimit për katet e para, kur këto nuk janë të parashikuara për banesa sociale	0
ç) Taksat, tatimet dhe tarifat vendore, të cilat, për projektin në fjalë, mund të jenë konsideruar, si kontribut i bashkisë	2200000

SHUMA II

LEKË

4,777,136

3. KOSTOJA E PËRGJITHSHME E NDËRTIMIT (SHUMA I - SHUMA II)

LEKË

88,704,593



FORMULARI NR. 4

LLOGARITJA E MASËS SË QIRASË SË APARTAMENTIT NR.

Banesa:

Qiramarrësi:

LLOGARITJA E QIRASË

a) Kostoja e përgjithshme e ndërtimit sipas formularit nr. 3 (K)	lekë	_____
b) Sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit (S)	m ²	_____
c) Sipërfaqja e apartamentit (S1)	m ²	_____
ç) Përqindja që zë sipërfaqja e apartamentit ndaj sip. totale (P=S1/S)	%	_____
d) Kostoja e apartamentit (Ks1= (a)x(d))	lekë	_____
dh) Qiraja mujore maksimale (Q= $\frac{Ks1 \times 0.04}{12}$)	lekë	_____

Shembull:

a) Kostoja e përgjithshme e ndërtimit sipas formularit nr. 3 (K)	lekë	88,704,593
b) Sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit (S)	m ²	3,074
c) Sipërfaqja e apartamentit (S1)	m ²	70.3
ç) Përqindja që zë sipërfaqja e apartamentit ndaj sip. totale (P=S1/S)	%	0.023
d) Kostoja e apartamentit (Ks1= (a)x(ç))	lekë	2,028,605
dh) Qiraja mujore maksimale (Q= $\frac{Ks1 \times 0.04}{12}$) = 2028605*0.04/12	lekë	6,762

12

**UDHËZIM****Nr. 11, datë 6.5.2016****PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË UDHËZIMIN NR. 30, DATË
27.12.2011, “PËR MENAXHIMIN E
AKTIVEVE NË NJËSITË E SEKTORIT
PUBLIK”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 6, germa “e”, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Pika 118 riformulohet si më poshtë vijon:

“Nxjerrja nga përdorimi i aktiveve financiare në formën e pjesëmarrjes në kapital, aktiveve afatgjata jomateriale, si: koncesione, patenta, licenca, rezervat shtetërore, terrenet dhe aktivet natyrore bëhet sipas dispozitave të veçanta ligjore në fuqi.”.

2. Pas pikës 118 shtohen pikat si më poshtë:

Nxjerrja nga përdorimi i ndërtesave

“118.1 Nxjerrja nga përdorimi i ndërtesave ekonomike dhe administrative do të bëhet duke u mbështetur në kriteret e përcaktuara në pikën 103 të udhëzimit. Për çdo objekt do të përgatitet një formular sipas modelit të caktuar në aneksin nr. 1, bashkëlidhur.

118.2 Në bazë të procesverbalit të vlerësimit të bërë nga komisioni i vlerësimit, titullari i njësisë publike miraton nxjerrjen nga përdorimi të ndërtesës, duke i trajtuar sipas rendit shterues më poshtë:

a) Në rastet kur objekti do të transferohet nga njësitë e qeverisjes qendrore në njësitë e qeverisjes vendore do të zbatohen procedurat që parashikon ligji nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit një njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;

b) Transferimi i objektit brenda njësisë të qeverisjes së përgjithshme ose dhe në njësitë e tjera publike duhet të bëhet mbi bazën e një marrëveshje dypalëshe, ndërmjet njësisë që e dhuron dhe njësisë përfituese, duke marrë dhe miratimin e Këshillit të Ministrave;

c) Nëse objekti është përcaktuar për t’u shitur do të zbatohen kriteret që përcaktohen në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”;

d) Për rastet kur objekti do të shkatërrohet, duhet të merret miratimi nga Këshilli i Ministrave. Projektvendimi i përgatitur nga institucioni propozues duhet të shoqërohet me një plan të detajuar për shkatërrimin e objektit, i cili duhet të përmbajë të paktën:

i) zgjidhjet teknike që lidhen me mënyrën e heqjes nga ndërtesa të objekteve të ndryshme të përfshira në të, mënyrën e ndarjes së ndërtesës nga pajisje të ndryshme elektrike ose infra-struktura të tjera, masat e sigurisë, masat e menaxhimit të mbeturinave, riciklimin ose asgjësimin e mbetjeve të gjeneruara nga heqja e ndërtesës në përputhje me rregullat përkatëse për këto procese;

ii) planzhvillimi në lidhje me ndërhyrjet në zonë pas heqjes së ndërtesës ose pjesëve të saj, menaxhimin e mbeturinave, heqjen dhe asgjësimin e materialeve të ndërtimit;

iii) shpenzimet e planifikuara që nevojiten për të realizuar shkatërrimin dhe proceset e tjera që lidhen me të deri në pastrimin e mjedisit;

iv) siguri ose dëshmi të tjera inxhinierike, që pas largimit të mbetjeve nuk do të ketë ndikime në stabilitetin e strukturës së tokës ose objekteve të tjera për rreth, të cilat mund të rrezikojnë jetën dhe shëndetin e njerëzve ose mjedisin.”.

3. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Arben Ahmeti



ANEKS NR. 1
FORMULAR PËR NXJERRJEN NGA PËRDORIMI TË NDËRTESAVE

Përshkrimi i aktivitetit	
Data e hyrjes në përdorim	
Vlera fillestare	
Shpenzimet kapitale të kryera	
Vlera e akumuluar e amortizimit	
Vlera e aktivitetit në kontabilitet	
Data e vlerësimit të nxjerrjes nga përdorimi	
Personi/institucioni përgjegjës për administrim	
Arsyet e nxjerrjes nga përdorimi	
Vlerësimi i ekspertit të fushës	
Metoda që propozohet për daljen nga përdorimi	

Nëpunësi zbatues/personi përgjegjës për financën

Data _____. _____. ____.

Nëpunësi autorizues/drejtuesi i njësisë publike

Data _____. _____. ____.

VENDIM
Nr. 25, datë 10.5.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Bashkim Dedjakryetar i Gjykatës Kushtetuese

Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 3.12.2015 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 69/23 Akti, që i përket:

KËRKUES: Konxhe Lakra (Xhaja), Hysen Dudija, përfaqësuar në gjykim me prokurë të posaçme nga avokat Dhimitraq Prifti.

SUBJEKT I INTERESUAR: Gjykata e Apelit Tiranë, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 94, datë 2.2.2009 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2014-496(44), datë

23.1.2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 43, 44, 49 dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Vladimir Kristo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuësve, që janë shprehur për pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuësit janë ekspertë kontabël të autorizuar. Në vitin 2001, me vendim të Gjykatës së Apelit Tiranë, ata janë caktuar për të kryer ekspertimin kontabël në çështjen penale me nr. 16 akti dhe nr. 536 vendimi, datë 24.12.2001, me të pandehur shtetasin Vehbi Alimuça. Detyra e tyre konsistonte në vlerësimin e situatës ekonomike dhe nxjerrjen e të dhënave të përpunuara për shoqërinë huamarrëse “Vefa Holding”. Ata kanë realizuar aktin përkatës në atë gjykim, por nuk janë paguar për punën e kryer.



2. Në këto kushte kërkesit i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në rrugë civile, me kërkesëpadi me objekt detyrimin e subjektit të interesuar, Gjykatës së Apelit Tiranë, t'ju shpërblejë punën për kryerjen e aktit të ekspertimit.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 9511, datë 27.12.2007, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë.

4. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 94, datë 2.2.2009, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe pushimin e gjykimit të çështjes. Ajo ka arsyetuar se në rastin në shqyrtim nuk ndodhej përpara një marrëdhënieje juridiko-civile midis palëve ndërgjyqëse, në mënyrë që konflikti midis tyre të zgjidhej nga gjykata civile. Shpërblimi i ekspertit caktohet me vendim gjyqësor penal për të cilin ata janë thirrur si ekspertë, prandaj kërkesit nuk legjitimohen të kërkojnë detyrimin përkatës si ekspertë. Çështja hyn në juridiksionin penal, pasi është gjykata penale ajo që ka dhënë vendimin për të zgjidhur mosmarrëveshjen. Sipas Gjykatës së Apelit çështja duhet të pushohet edhe për shkakun tjetër se çdo detyrim i rrjedhur nga procedimi penal i përfunduar në vendim, në formën e detyrimit për shpenzimet procedurale, ekzekutohet nga zyra e përmbarimit.

5. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2014-496 (44), datë 23.1.2014, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 94, datë 2.2.2009 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

II

6. *Kërkesit* i janë drejtuar kësaj Gjykate duke pretenduar shfuqizimin e vendimeve objekt kërkesë. Ata kanë parashtruar në mënyrë të përmbledhur se:

6.1. Gjykata e Apelit ka gabuar kur ka përcaktuar se nuk ndodhej përpara një marrëdhënieje juridiko-civile, pasi marrëdhëniet midis kërkesve dhe gjykatës që i ka thirrur si ekspertë janë të raportit punë-shpërblim.

6.2. Gjykata e Apelit, edhe pse ka vendosur në bazë të nenit 485/2 të KPP-së, e ka interpretuar atë në mënyrë të gabuar dhe ka vendosur në kundërshtim të hapur me përmbajtjen e tij.

6.3. Gjykata e Apelit ka cenuar nenin 44 të Kushtetutës, pasi kërkesit pretendojnë të zhdëmtohen për një drejtë të shkelur.

6.4. Gjykata e Apelit ka arsyetuar në kundërshtim me nenin 32 të KPC-së kur ka vendosur lidhur me mungesën e legjitimitetit të kërkesve për të ngritur një padi të tillë.

6.5. Vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë është kontradiktor, sepse edhe pse pranon detyrimin për shpërblim të ekspertëve, nuk i jep rrugëzgjdhje mosmarrëveshjes.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkesve

7. Gjykata vlerëson se kërkesit legjitimohen *ratione personae*, në kuptim të rregullimit kushtetues të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, dhe *ratione temporis*, pasi pretendimet e tyre janë paraqitur brenda afatit ligjor dyvjeçar të parashikuar nga neni 30/2 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

8. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae* Gjykata ka theksuar se bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës ajo vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individit për shkeljen e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi ai të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e kësaj të drejte, çka nënkupton që kërkesi duhet t'i shfrytëzojë, në shkallët e sistemit gjyqësor, të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të së drejtës së pretenduar. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimin nr. 48, datë 6.7.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Në rastin në shqyrtim, Gjykata konstaton se kërkesit nuk kanë në dispozicion mjet tjetër për të kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Apelit dhe atë të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Për këtë arsye ata legjitimohen t'i drejtohen me kërkesë kësaj Gjykate. Gjithashtu, Gjykata çmon se pretendimet e kërkesve *prima facie* bien në fushën e veprimit të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, prandaj ato do të shqyrtohen në vijim në këndvështrim të standardeve që imponon procesi i rregullt ligjor në kuptimin kushtetues.

B. Për cenimin e së drejtës së aksesit dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor



10. Kërkuesit pretendojnë se Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë kanë gabuar në përcaktimin e marrëdhënies juridike ndërmjet palëve. Ato, edhe pse kanë vendosur në bazë të nenit 485/2 të KPP-së, e kanë interpretuar atë në mënyrë të gabuar. Sipas kërkuesve, vendimi i Gjykatës së Apelit dhe ai i Gjykatës së Lartë janë kontradiktorë, sepse edhe pse pranojnë detyrimin për shpërblim të ekspertëve, nuk i japin rrugëzgjdhje mosmarrëveshjes.

11. Bazuar në parimin *jura novit curia* Gjykata ka theksuar se ajo mund të vlerësojë vetë nëse pretendimet e ngritura në kërkesë bien në fushën e veprimit të një dispozite të caktuar, që nuk është parashtruar para saj dhe se ajo nuk e konsideron veten të detyruar nga cilësimi që u është bërë fakteve të çështjes nga kërkuesi (*shih vendimin nr. 27, datë 9.5.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se pavarësisht nga mënyra e formulimit të kërkesës, pretendimet e kërkuesve se Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë nuk i kanë dhënë rrugëzgjdhje mosmarrëveshjes, duhet të trajtohen në këndvështrimin e respektimit të së drejtës së aksesit në gjykatë, si dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

12. Në jurisprudencën e saj Gjykata është shprehur se e drejta për t'iu drejtuar gjykatës është një nga elementet më të rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ). Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Mohimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 28, datë 15.3.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Gjithashtu, Gjykata ka vlerësuar se neni 42 i Kushtetutës sanksionon në vetvete jo vetëm të drejtën e individit për t'iu drejtuar gjykatës, por edhe detyrimin e shtetit që t'ia garantojë atij këtë

akses. Gjykata ka konsideruar se sipas këtij neni detyrimi për të garantuar të drejtën efektive të aksesit në gjykatë nuk nënkupton thjesht mungesën e një ndërhyrjeje, por mund të kërkojë ndërmarrjen e veprimeve pozitive nga ana e shtetit. Në rast se mohohet një e drejtë e tillë, procesi konsiderohet jo i rregullt, sepse aksesit në gjykatë është para së gjithash një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimin nr. 67, datë 17.11.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Ky qëndrim i Gjykatës është në një linjë me qëndrimet tashmë të konsoliduara të GJEDNJ-së apo gjykatave të tjera simotra. GJEDNJ-ja, që në vitin 1975, në çështjen Golder kundër United Kingdom (çështja 4451/70, vendimi datë 21.2.1975, § 35), është shprehur se “do të ishte e pakonceptueshme, sipas mendimit të Gjykatës, që neni 6 § 1 të përshkruajë në detaje garancitë procedurale që u ofrohen palëve gjatë një procesi dhe të mos mbrojnë në radhë të parë atë që në fakt bën të mundur përfitimin e garancive të tilla, që është aksesit në një gjykatë. Karakteristikat e procedurave gjyqësore, të tilla si: rregullsia, publiciteti dhe shpejtësia, nuk do të kenë fare vlerë nëse nuk ka procedura gjyqësore”. Pra, duke bërë një interpretim të të “drejtave efektive”, GJEDNJ-ja në vendimin Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar përcaktoi se garancitë e procesit të rregullt ligjor, të parashikuara në detaje nga neni 6 i KEDNJ-së, do të ishin të pavlefshme nëse do të ishte i pamundur fillimi i një procesi gjyqësor¹.

15. GJEDNJ-ja edhe në çështjen *McElhinney kundër Irlandës* (aplikimi nr. [31253/96](#), § 33), si dhe në çështjen *T.P. dhe K.M. kundër Mbretërisë së Bashkuar* (aplikimi nr. [28945/95](#), § 96), ka ritheksuar se e drejta e aksesit “është një aspekt i pandarë i garancive të mishëruara në nenin 6, duke iu referuar parimeve të shtetit të së drejtës dhe të shmangies së pushtetit arbitrar, që qëndrojnë në themel të Konventës. Kështu, neni 6 § 1 i siguron gjithsecilit të drejtën për të pasur çfarëdo pretendimi në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij civile përpara një gjykatë”.

16. Nga sa më lart, Gjykata vlerëson se në aspektin kushtetues dhe në këndvështrimin e mjetit efektiv, e drejta e aksesit hyn në të drejtat themelore të individit, të cilat në çdo rast duhet

¹ Shih The European Convention on Human Rights, Jacobs & White, Oxford, Fourth Edition, f. 170.



të garantohen nga gjykatat. Çdo mosmarrëveshje apo kundërshti ndërmjet organeve shtetërore dhe individit duhet të ketë si destinacion përfundimtar gjykatat, të cilat duhet t'u japin përgjigje pretendimeve të tyre. Në këtë kuptim, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm brenda hapësirës së juridiksionit të tyre dhe në respekt të parimit të gjykatës së caktuar me ligj, si dhe të parimit të kushtetutshmërisë, gjatë shqyrtimit të mosmarrëveshjeve janë të detyruara të zbatojnë të drejtat dhe standardet kushtetuese.

17. Lidhur me standardin e arsytimit të vendimit, Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsytimit të vendimeve gjyqësore si një garanci për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Funksioni i një vendimi të arsytuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimin nr. 18, datë 15.3.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim, vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsytuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese (*shih vendimet nr. 3, datë 26.1.2015; nr. 63, datë 23.9.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsytimin e vendimeve të tyre. Ajo ka verifikuar nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërthënie, përmban referenca në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjitha elementet e sipërpërmendura. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se detyrimi për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të

çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit dhe se masa e arsytimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimin nr. 18, datë 15.3.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në rastin në shqyrtim, nga vendimet bashkëlidhur kërkesës, Gjykata konstaton se kërkesuesit, me vendim të Kolegjit Penal të Gjykatës së Apelit Tiranë, janë caktuar për të kryer ekspertimin kontabël në çështjen penale me nr. 16 akti dhe nr. 536 vendimi, datë 24.12.2001, me të pandehur shtetasin Vehbi Alimuça. Detyra e tyre konsistonte në vlerësimin e situatës ekonomike dhe nxjerrjen e të dhënave të përpunuara për shoqërinë huamarrëse "Vefa Holding". Ata kanë realizuar aktin përkatës në atë gjykim, por nuk janë paguar për punën e kryer. Ata i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë duke kërkuar shpërblimin për detyrën e lartpërmendur. Kjo e fundit ka pranuar kërkesëpadinë duke arsytuar se në bazë të neneve 183/2 dhe 485 të KPP-së, shpërblimi i ekspertëve përcaktohet me urdhër të organit dhe parapaguhet nga shteti. Në rastin në shqyrtim, llogaritja e shpërblimit të kërkesuesve është bërë në bazë të aktit të ekspertimit të realizuar në gjykim nga ekspertët që caktoi gjykata.

20. Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së rrethit dhe pushimin e çështjes me arsytimin se shpërblimi i ekspertit caktohet me vendimin gjyqësor penal nga gjykata që i ka thirrur si ekspertë, prandaj kërkesuesit nuk legjitimohen të kërkojnë detyrimin e tyre përkatës si ekspertë në gjykatën civile. Sipas Gjykatës së Apelit çështja hyn në juridiksionin penal, pasi është gjykata penale ajo që ka dhënë vendimin për të zgjidhur mosmarrëveshjen. Po këtë qëndrim ka mbajtur edhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.

21. Nga sa më lart, Gjykata konstaton se Gjykata e Apelit edhe pse ka arsytuar se çështja nuk hyn në juridiksionin civil, pavarësisht parashikimit të nenit 61 të KPC-së, sipas të cilit kur gjykata konstaton se nuk është kompetente për gjykimin e çështjes kryesisht vendos moskompetencën e saj dhe i dërgon aktet në gjykatën kompetente, jo vetëm nuk ia ka dërguar aktet gjykatës penale, por i ka hyrë shqyrtimit të themelit duke vendosur pushimin e çështjes.

22. Për më tepër, Gjykata konstaton se pushimi i çështjes nga ana e vendimit të Gjykatës së Apelit, i lënë në fuqi nga Gjykata e Lartë, i ka



mbyllur përfundimisht kërkuesve mundësinë e një zgjidhjeje përfundimtare të çështjes, pasi në kushtet kur procesi penal, në të cilin ekspertët janë thirrur, ka përfunduar, ata nuk mund të ankohen më ndaj vendimit penal, sepse nuk janë palë ndërgjyqëse të tij.

23. Gjithashtu, Gjykata vëren se mangësitë e Gjykatës së Apelit nuk janë korrigjuar as nga vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, i cili, në ndryshim nga Gjykata e Apelit, edhe pse çmon se kërkuesit kanë interes të ligjshëm për të paraqitur kërkesëpadinë, në mënyrë alogjike ka vlerësuar se rruga e zgjedhur nga kërkuesit për të realizuar këtë të drejtë është e gabuar (*shih paragrafin nr. 24 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Gjykata konstaton se edhe pse të dyja gjykatat (Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë) në vendimet e tyre arsyetojnë se ekspertët sipas ligjit (nenet 183/2 dhe 485/2 të KPP-së) duhet të shpërblehen për punën e kryer, në mënyrë kontradiktore nuk vendosin në favor të zgjidhjes në themel të çështjes.

24. Bazuar në këto konstatime, Gjykata vlerëson se vendimet e kundërshtuara, duke qenë të pasakta dhe kontradiktore, kanë ndikuar edhe në cenimin e së drejtës së aksesit substancial të kërkuesve. Në këtë këndvështrim, Gjykata në jurisprudencën e saj ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave. Konkretisht, e drejta për të pasur akses në gjykatë i garanton individit të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj, të arsyetuar, për pretendimet e ngritura (*shih vendimin nr. 62, datë 23.9.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesve për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, janë të bazuara.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
 - Shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr. 94, datë 2.2.2009 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr. 00-2014-496(44), datë 23.1.2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
 - Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Tiranë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Vladimir Kristo, Fatos Lulo

Anëtar kundër: Sokol Berberi

VENDIM

Nr. 48, datë 29.4.2016

MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIM E SHOQËRISË “XHENGO ENERGJI” SHPK, NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “KASOLLET E SELCËS”

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “a” dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a”; 10, pika 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18, pika 1, germa “a”, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.4.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Xhengo Energji” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për licencimin e kësaj shoqërie në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kasollet e Selcës”,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Xhengo Energji” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit,



modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9 pika 3, gjerat “a”, “b” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni teknik-ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5, gjerat “a” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Dokumentet që vërtetojnë aftësinë dhe/ose mbështetjen financiare të aplikuesit (neni 9, pika 3, gjerat “c”);
- Lejen e përdorimit të ujit për prodhimin e energjisë elektrike (neni 9, pika 4.1.5, gjerat “b”), do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “Xhengo Energji” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-i “Kasollet e Selcës”, me fuqi të instaluar 4000 kw.

2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 49, datë 29.4.2016

MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “XHENGO ENERGJI” SHPK, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, gjerat “d” dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, gjerat “g”;
Faqe| 4540

5, pika 2; 10, pika 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve ERE-s nr. 108, datë 9.9.2008 dhe neni 18, pika 1, gjerat “a” e “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.3.2009 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.4.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Xhengo Energji” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Xhengo Energji” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1), është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2), është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Të dhënat specifike sipas tipit të licencës (neni 9, pika 4/10, gjerat “a”, “b” dhe “c”) janë plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “Xhengo Energji” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 50, datë 29.4.2016****MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “XHENGO
ENERGJI” SHPK, NË AKTIVITETIN E
FURNIZIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “ç” dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “P”; 5, pika 1, germa “P”; 10, pika 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18, pika 1, germa “a”, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.4.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Xhengo Energji” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për licencimin në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Xhengo Energji” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizuesit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4/9, germa “a”, germa “b” dhe germa “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “Xhengo Energji” sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM**Nr. 51, datë 29.4.2016****MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË
“LIRIA ENERGJI” SHPK NË
AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC
“SHPELLA POSHTË 2”, ME FUQI TË
INSTALUAR 2300 kw**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “a” dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a”; 13 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.4.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Liria Energji” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie nga HEC “Shpella Poshtë 2”,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Liria Energji” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik-ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4 dhe 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s



VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Liria Energji” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Shpella Poshtë 2”, me fuqi të instaluar 2300 kw për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 52, datë 29.4.2016

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË
“LIRIA ENERGJI” SHPK, NË
AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “d” dhe 110, të ligjit nr.43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “g”; 5, pika 2 dhe nenit 13, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve ERE-s nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.4.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Liria Energji” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie, konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Liria Energji” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Të dhënat specifike sipas tipit të licencës (neni 9, pika 4/10 germat “a”, “b”, “c”) janë plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Liria Energji” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 53, datë 29.4.2016

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË
“LIRIA ENERGJI” SHPK, NË
AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “ç” dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “f”; 5, pika 1, germa “f”, dhe nenit 13, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.4.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Liria Energji” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve për licencimin në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Liria Energji” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9, germat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s



VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Liria Energji” sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti

VENDIM

Nr. 54, datë 29.4.2016

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “AE
DISTRIBUTION” SHPK NË
AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “d” dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “g”; 5, pika 1, germa “g”; 10, pika 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18, pika 1, germa “a” e “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.4.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “AE Distribution” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “AE Distribution” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germa “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germa “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Të dhënat specifike të licencës (neni 9, pika 4/10, germa “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “AE Distribution” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti

VENDIM

Nr. 55, datë 29.4.2016

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “AE
DISTRIBUTION” SHPK NË
AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “ç” dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “f”; 5, pika 1, germa “f”; 10, pika 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18, pika 1, germa “a”, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.4.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “AE Distribution” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për licencimin në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:



Aplikimi i shoqërisë “AE Distribution” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizuesit të energjisë elektrike (neni 9, pikat 4/9, germat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “AE Distribution” sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 56, datë 29.4.2016

MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “DEVOLL HYDROPOWER” SHA NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “ç” dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “f”; 5, pika 1, germa “f”; 10, pika 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18, pika 1, germa “a”, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.4.2016, mbasi

shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për licencimin në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizuesit të energjisë elektrike (neni 9, pikat 4/9, germat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germa “a”) do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 57, datë 29.4.2016**

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “DAAB
ENERGY GROUP” SHPK NË
AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC
“DOBRENJË–TOMORRICË”, ME FUQI
TË INSTALUAR 2400 kw**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “a” dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a”; 10, pika 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18, pika 1, germa “a”, e “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.4.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Daab Energy Group” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie nga HEC “Dobrenjë–Tomorricë”,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Daab Energy Group” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat “a”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni teknik-ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4 dhe 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germa “b”) do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores “Për procedurat e licencimit,

modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “Daab Energy Group” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Dobrenjë–Tomorricë”, me fuqi të instaluar 2400 kw.

2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM**Nr. 58, datë 29.4.2016**

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “DAAB
ENERGY GROUP” SHPK NË
AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “d” dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “g”; 5, pika 2; 10, pika 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18, pika 1, germa “a”, e “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.4.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Daab Energy Group” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Daab Energy Group” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e



licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germa “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Të dhënat specifike të licencës (neni 9, pika 4/10, germa “c”) janë plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germa “c”);
- Të dhënat specifike të licencës (neni 9, pika 4/10, gjerat “a” dhe “b”) do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “Daab Energy Group” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrir Ahmeti

VENDIM

Nr. 59, datë 29.4.2016

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E “KUSHTEVE TË PËRGJITHSHME TË KONTRATËS SË SHËRBIMIT UNIVERSAL TË FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE PËR KLIENTËT FUNDORË”

Në mbështetje të nenit 16, 20, gjerat “a” dhe “h”; nenit 80, 81, 82, 83, 84, 85, 94 dhe 96 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe nenit 25 të “Rregullave të

praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.3.2009, të ERE-s, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.4.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e draftkontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë, të përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për miratimin e kushteve të përgjithshme të “Kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrir Ahmeti

VENDIM

Nr. 60, datë 29.4.2016

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E DRAFTRREGULLORES PËR LIDHJET E REJA NË SISTEMIN E SHPËRNDARJES

Në mbështetje të nenit 16, 27, pika 3, 108 dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 25, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin të Bordit të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, si dhe Kodit të Shpërndarjes, të miratuar me vendimin nr. 100, datë 26.8.2008, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.4.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e paraqitur për fillimin e procedurave për shqyrtimin e draftrregullores për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes,

konstatoi se:

- Me shkresën nr. 5831/1, prot. 25.3.2016 dhe nr. 278 prot. hyrës, datë 29.3.2016, subjekti OSHEE sh.a., ka propozuar “Draftin me ndryshimet e kërkuara në rregulloren e lidhjeve të reja për të shkurtuar punën normale të OSHEE-së në garantimin e pandërprerë të energjisë elektrike dhe parametrave teknikë të saj”.



- Nga rekomandimet e grupit ndërinstitucional për vlerësimin, përmirësimin dhe monitorimin e indikatorëve të “Doing Business”, të ngritur me urdhër të Këshillit të Ministrave nr. 30, datë 30.1.2014, me këtë draftparashtrohet lehtësimi i procedurave për furnizimin me energji elektrike të objekteve veçanërisht të bizneseve.

- Mbështetur në “Rregullat e praktikës dhe procedurave të ERE-s”, ERE shprehet me vendim për fillimin e procedurës për shqyrtimin e draftit të propozuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e draftrregullores për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

KËRKESË

Shtetasja Elona Abdishahi, e bija e Zijait dhe e Dylberes, e datëlindjes 7.6.1981, lindur dhe banuese në Tilaj, Bashkia Kavajë, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, shpalljen të zhdukur të shtetasit Jovan Doce, i biri i Zametit dhe i Jemikes, i datëlindjes 23.2.1970.

KËRKUES
Elona Abdishahi

KËRKESË

Shtetasi Osmen Gishti, i biri i Nexhipit dhe i Qamiles, i datëlindjes 20.8.1940, lindur dhe banues në fshatin Kraps, Bashkia Fier, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, shpalljen të zhdukur të motrës së tij, shtetasës Vezire Gishti.

KËRKUES
Osmen Gishti

KËRKESË

Shtetasja Servete Agaçi (Dema), e bija e Ismailit dhe e Hilmijes, e datëlindjes 21.2.1940, lindur dhe banuese në fshatin Homezh, të Njësisë Administrative Shupenzë, Tiranë, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, shpalljen të zhdukur shtetasit Imer Dine Dema, i datëlindjes 9.10.1932, më 1.1.1975.

KËRKUES
Servete Agaçi (Dema)

KËRKESË

Shtetasja Servete Agaçi (Dema), e bija e Ismailit dhe e Hilmijes, e datëlindjes 21.2.1940, lindur dhe banuese në fshatin Homezh, të Njësisë Administrative Shupenzë, Tiranë, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, shpalljen të zhdukur shtetasit Ahmet Dine Dema, i datëlindjes 17.8.1929, më 1.1.1975.

KËRKUES
Servete Agaçi (Dema)



SAKTËSIM TË DHËNASH

Tabelat e sakta me pasqyrimin e kolonës së çmimeve, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 14, datë 5.2.2016.

**VLERA E PASURISE SE PALUAJTSHME TE LLOJIT TOKE BUJQESORE,
LIVADHE KULLOTA DHE PYJORE PER BASHKINE DURRES**

2014


NR	QYTETI, FSHATI	NUMRI ZONES KADASTRALE	TOKE BUKQESORE (hektar/m ²) 2014	LIVADHE KULLOTA (hektar/m ²) 2014	TOKE PYJORE (hektar/m ²) 2014
1	ADRIATIK	2117	397	117	100
2	ARAPAJ	1031	361	117	182
3	ARMATH	1098	397	117	100
4	BISHT KAMEZ	1198	356	117	182
5	BIZE	1204	273	117	100
6	BORCE	1243	331	117	100
7	BOZANXHIE	1256	339	117	100
8	DRAÇ	1522	320	117	182
9	ERZEN	1595	397	117	100
10	FLAKE	2117	397	117	100
11	FSHAT MANEZ		339	117	100
12	GIURICAJ	1771	397	117	100
13	HAMALLAJ	1925	549	117	182
14	HAMALLAJ	1924	397	117	182
15	HIDROVORI		397	117	100
16	JUBE	2009	397	117	182
17	KAMERAS	2065	397	117	100
18	KAPIDANAJ	2078	397	117	100
19	KATUND I RI	2117	356	117	100
20	KERTUSHAJ	2147	397	117	100
21	KULLE	2321	397	117	100
22	KURATEN	2332	397	117	100
23	LANEZ	2375	337	117	182
24	LUKMETAJ	2453	397	117	100
25	MALIQ MUÇO	2574	227	117	100
26	MANSKURI	2591	392	117	182
27	NB FRUTORE	1574	397	117	100
28	PERLAT	3541	397	117	100
29	QERRRET	3102	339	117	100
30	RADE	3137	339	117	100
31	RINIA	3184	554	117	182
32	ROMANAT	3236	397	117	100
33	RRASHKULL	3215	397	117	100
34	RRUSHKULL	3241	397	117	182
35	SHENAVLASH	3339	356	117	100
36	SHTETI	3365	337	117	182
37	SHKALLE	3383	397	117	100
38	SHKALLINUR	3385	227	117	182
39	SUKTH	3541	397	117	100
40	SUKTH I RI	3542	397	117	100
41	VADARDHE	3690	339	117	100
42	XHAFTOTAJ	3852	339	117	100



**VLERË E PASURISË SE PALUAJTSHME TE LLOJIT TOKE BUJQESORE,
LIVADHE KULLOTA DHE PYJORE PER BASHKINË DIVJAKE
2014**


LEGIENDA

Nr.	QYTETI/ESHAT	NUMRI ZONËS MADRORAL E	TOKE BUJQESORE (hektar) 2014	LIVADHE KULLOTA (hektar) 2014	TOKE PYJORE (hektar) 2014
1	ADRIATIK	3166	364	117	100
2	BABUNE	1067	364	117	100
3	BISHÇUKAS	1193	364	117	100
4	BREGAS	1271	364	117	100
5	ÇERMË E POSHTEME	1380	364	117	100
6	ÇERMË E SIPERME	1381	364	117	100
7	ÇERMË PASHA	3578	364	117	100
8	ÇERMË PROSHKE	1382	364	117	100
9	ÇERMË SHKUNBIN	3578	364	117	100
10	ÇERMË VOGEL	2271	364	117	100
11	DUSHK CAN	1746	364	117	100
12	FERRAS	1610	364	117	100
13	PIER SEMAN	1620	364	117	100
14	GERMENI I MADH	1708	364	117	100
15	GERMENI I VOGEL	1709	364	117	100
16	GORICAJ	1804	364	117	100
17	GRABIAN	1827	364	117	100
18	GRADISHTE	1838	364	117	100
19	GUNGAS	1882	364	117	100
20	GUR	1883	364	117	100
21	HALVAXHIAS	1612	364	117	100
22	KAMENICE	2064	364	117	100
23	KARAVASTA	2084	364	117	100
24	KARAVASTA E RE	2085	364	117	100
25	KEMISHTAJ	2135	364	117	100
26	KRYEKUQ	2289	364	117	100
27	MERISHT	2663	364	117	100
28	MIZE	2700	364	117	100
29	MUÇIAS	2728	364	117	100
30	REMAIS	3166	364	117	100
31	SHENEPREMITË	3341	364	117	100
32	SOPEZ	3486	364	117	100
33	SPOLATE	3503	364	117	100
34	STRAVEC	3982	364	117	100
35	SULZOTAJ	3547	364	117	100
36	TERBUF	3578	364	117	100
37	XING	3848	364	117	100
38	ZHARNËC	3921	364	117	100





VLERE E PASURISE SE PALUAJTSHME TE LLOJIT TOKE TRUALL
QYTETI KONISPOL
2014



Nr.	QYTETI, FSHATI	NUMRI I ZONES KADASTRALE	TOKE TRUALL (leke/m ²) 2014
	KONISPOL	2217	1587

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 156 lekë